



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:127157  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05759362

**PA1.nr.1590/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësorë Visar Gashi si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit J.K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 paragrafi 3 nen parag.3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së dhe veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit J.K, av. B.B të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, P.nr.183/23 i datës 19.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit J.K, av. B.B, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, P.nr.183/23, i datës 19.09.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Prizren- Dega në Suharekë me aktgjykimin P.nr.183/23, të datës 19.09.2023, të akuzuarin J.K, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë

trupor, nga neni 185 paragrafi 3 nën parag.3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, në dënimin e shqiptuar me burgim koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej 30 ditësh i llogaritet në shqiptimin e dënimit. Me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim i mbetur në kohëzgjatje prej 150 ditësh i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1500 € (njëmijë e pesëqind euro) të cilin dënim duhet ta paguaj në 5 këste të barabarta pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në çoftë se nuk do të paguhet ose nuk mund të paguhet nga i pandehuri, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që 20 € € (njëzet euro) e dënimit me gjobë llogaritet me 1 (një) ditë burgim. Për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqind euro) të cilin duhet ta paguaj 15 ditë nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Në çoftë se nuk do të paguhet ose nuk mund të paguhet nga i pandehuri, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që 20 € € (njëzet euro) e dënimit me gjobë llogaritet me 1 (një) ditë burgim. Konform nenit 76 gjykata të akuzuarin e ka gjykuar me dënim unik me gjobë në shumën prej 1800 € (njëmijë e tetëqind euro) të cilin dënim duhet ta paguaj në kohëzgjatje prej 5 muajve dhe në 5 këste të barabarta pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në çoftë se nuk do të paguhet ose nuk mund të paguhet nga i pandehuri, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që 20 € € (njëzet euro) e dënimit me gjobë llogaritet me 1 (një) ditë burgim. Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 (njëzet) Euro, në emër të taksës për kompensim të viktimat të krimit shumë prej 20 (njëzet) euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20 (njëzet) Euro të gjitha pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar. E dëmtuara B.K për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:**

Mbrojtësi i të akuzuarit J.K, av. B.B, për shkak shkeljes së dispozitave procedurale, shkeljes së ligjit penal dhe të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim Gjykata e Apelit e Kosovës, ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen t'ia kthej shkallës së parë për rigjykim dhe vendim.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1623/23 të datës 15.12.2023, ka propozuar që të refuzohet si të pabazuara ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.K, av. B.B, ndërsa aktgjykimi i ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, P.nr.183/23, i datës 29.09.2023, vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPRK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

#### **-Ankesa është e pabazuara.**

Gjykata e Apelit duke i shqyrtuar pretendimet ankimore sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale gjithashtu, duke u bazuar në nenin 394, të KPPRK, edhe sipas

detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit edhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, të cilat kjo gjykatë i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Në arsyetimin e aktgjykimit përkitazi me ngjarjen në fjalë, janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridike penale, duke qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale të ilat i janë ngarkuar me aktakuzë e të cilin pranim gjykata e shkallës së parë e ka miratuar duke konstatuar se pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me dispozitat e KPPRK-së, konstatime këto të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimin për këtë.

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se Gjykata me rastin e shqiptimit të sanksionit penal nuk i ka marrë për bazë rrethanat dhe faktet të cilat do të ndikonin që të akuzuarit t'i shqiptohej sanksion tjetër penal me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit i paraparë me KPRK-së. Dënimi i shqiptuar nga gjykata nuk i përgjigjet peshës së veprës penale, rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, rrethanave personale të kryerësit, përgjegjësisë penale dhe personalitetit të të akuzuarit. Me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Sipas Kodit Penal gjykata nuk cakton gjobë në lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit. Në rastin konkret dënimi me gjobë në lartësi prej 1,800.00 € është shumë i lartë dhe jo proporcional me gjendjen pasurore të pandehurit dhe mbi mundësitë financiare të të pandehurit. I pandehuri është i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, mbajtës edhe 4 anëtareve, me këtë dënim do të rrezikohej ekzistenca e tij dhe familjes së tij. Me caktimin e sanksionit penal gjykata nuk ka marrë parasysh rrethanat e me poshtme lehtësuese: rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale rrethanat në të cilat është kryer vepra penale provokimi dhe nxitja nga e dëmtuara, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar i mbrojturi im shquhet për karakterin impulsivie bie nën ndikimin e emocioneve dhe situatave provokuese. I mbrojturi im ka vepruar nën ndikimin e emocioneve, dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale i mbrojturi im ka rënë nën ndikimin dhe provokimin e të dëmtuarës e cila në vazhdimësi ka bërë video ingjizmin e familjes dhe të mbrojturit dhe ka kryer këtë vepër penale. Nga provat e lëndës vërehet kuptohet pa dyshim, qartë se e dëmtuara pasi e provokon të mbrojturin tim nisat në drejtim të tij dhe i gjendur në një situatë të tillë edhe kryen veprën penale ndaj të dëmtuarës; bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar që në fazën parapenale e deri në marrjen e aktgjykimit. I mbrojturi im ka qenë bashkëpunues me të gjitha organet e ndjekjes penale e posaçërisht me gjykatën si në procedurën paraprake po edhe në shqyrtimin fillestar e gjyqësor duke i pranuar të gjitha veprimet e tij pa u menduar fare për pasojat edhe pse veprimet e tij kanë pasur për pasojë shkeljen e ligjit e për të cilat është paraparë sanksioni penal. I mbrojturi im ka kuptuar gabimin tij se ka kryer një vepër penale për të cilën është paraparë sanksioni penal dhe meqenëse ka kryer veprën penale është pajtuar që të merr edhe dënimin meritator për veprën e kryer. Dënimi unik me gjobë prej 1,600.00 € është dënim shumë i lartë në krahasim me bashkëpunimin e tij që ka pasur me gjykatën si dhe gjendjen financiare të mbrojturit tim; bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose

ndjekjen penale i mbrojturi im ka pasur një bashkëpunim ne fazën e hetimeve ku para zyrtareve policor por edhe prokurorisë i pranon të gjitha veprimet e tij pa asnjë kundërshtim përkundër pasojave që kanë pasur veprimet e tij, deklarimet e tij kanë qenë të sinqerta dhe kanë gjetur mbështetje me provat tjera; pranimin e fajit i mbrojtur im asnjëherë nuk ka tentuar të i shmanget përgjegjësisë penale ka pranuar fajin në shqyrtimin fillestar; keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar i mbrojturi im ka shprehur keqardhjen për rastin e ndodhur menjëherë pas kryerjes së veprës penale dhe ne prezencë te palëve ne shqyrtimin fillestar; sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit i mbrojturi im pas konfliktit nuk ka pasur ndonjë rast tjetër me të dëmtuarën apo edhe ndonjë person ku ka cilësinë e të pandehurit në procedurës përkundrazi i njëjti tani më është shumë i kujdesshëm në komunikimin dhe sjelljen me të tjerët, kontrollimin e ndjenjave dhe emocioneve, është njeri familjar angazhohet për mbajtje të familjes dhe përkujdesje të saj tani më pas këtij rasti i kontrollon situatat nxitëse - provokative duke iu shmangur shkeljes se ligjit. Qëllimi i dënimit - Risocializimin e tij, arrihet edhe me një dënim më të ulët.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të të akuzuarit nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë që në shqyrtimin fillestarë, ka deklaruar se ndihet bi penduar për veprës penale të kryer, ka premtuar se nuk do ti përsërisë asnjëherë veprën penale, të dëmtuarës i ka kërkuar falje publike si dhe është i gjendjes së varfër ekonomike dhe i pa punë. Ndërsa rrethanë rënduese gjykata ka marrë shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprave penale dhe rrezikimin e vlerës së mbrojtur siç është jeta dhe integriteti i të dëmtuarës në kuadër të marrëdhënies familjare. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimi të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që ti parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit , të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet ankimore, nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim tjetër. Të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale , posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit

të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PA1.nr.1590/23, më datë 30.05.2024**

**Procesmbajtës,**

Visar Gashi

---

**Anëtarët e kolegjit:**

Skender Çoçaj

---

**Kryetar i kolegjit,**

Abdullah Ahemti

---

Ferit Osmani

---

Numri i lëndës: 2023:127157  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05759362